

09-04-2018
GJKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu në lëndën penale kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak të veprës penale në bashkë kryerje vjedhje e rënd nga neni 327 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.2794-1/14 të datës 19.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 09.01.2018, në prani të prokurorit të shtetit Sebahate Sinani, të akuzuarit [REDACTED] shpall dhe publikisht komunikon ndërsa me date 22.02.2018 përpiloi me shkrim këtë aktgjykim

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Kaçanik, i lindur me datë [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] i pa pune, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse me datë 08.11.2014 rreth orës 11:05, në fshatin [REDACTED] K. Kaçanik me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete te pasurisë se luajtshme te tjetrit, ashtu qe ne bash kryerje kane hyre ne shtëpinë e te dëmtuarit, [REDACTED], i cili gjendet ne Zvicër, duke e përdorur forcën kishin thyer një dritare te shtëpisë me diametër 50x60 cm, nga aty ishin futur brenda kishin vjedhur nje telefon “ Samsung” me ngjyre te bardhe e qe sipas vëllaut te te dëmtuarit [REDACTED] vlera e te cilit është rreth 50 euro.

me të cilën ka kryer veprën penale në bashkryerje vjedhje e rënd nga neni 327 par.1 lidhur me neni 31 të KPRK-së,

Andaj gjykata ne baze të neneve 4,7,17,21,41,46,51,73 si dhe neni 365 të KPRK-së, shqipton:

SHQIPTON

DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ 1/një/vit i cili dënim nuk do të ekzekutohen në rast se i akuzuari brenda 2/dy/viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale (koha e verifikimit),dhe

DHE DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 400/katërqind/ euro, të cilit i mundësohet ta paguaj me këste mujore ne afat prej 2 /dy/ muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

I dëmtuar [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Kaçanik për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet te akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajnë shumën 30 /tridhjetë/€ në afatin prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/II.nr..2794-1/14 të datës 19.03.2015 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për veprën penale

ne bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31të KPRK-së, për te akuzuarin [REDAKTUAR] është mbajtur shqyrtimi gjyqësor më datë 09.01.2018 dhe të njëjtit ju ka shqiptuar dënimi me aktgjykim P.nr.342/15, ndërsa është veçuar procedura me aktvendim për të akuamarin [REDAKTUAR] pasi i njëjti në bazë të verifikimit nga ana e policisë ka qene jashtë vendit- Gjermani.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 09.01.2018, në të cilën shqyrtim i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, shpreh keqardhjen dhe është i penduar thellë për veprën e kryer duke theksuar se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, i premtoj gjykatës që në ardhmen do të jem i kujdesshëm dhe nuk do të përsëris vepra të tilla penale, lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të bute.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: deklarata e te pandehurve e dt:14.11.2014, deklarata e dëshmitarit e dt:18.03.2015, si dhe fotografit qe gjenden ne shkresat e lëndës.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprën në **bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31të KPRK-së.**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73,75,76 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, gjykata ka bërë zbutjen e dënimit nën minimujmin e parapare ligjorë nga 3(tri) vite ne 1(një) vit burgim me kusht, shpreh

keqardhjen dhe është i penduar thellë për veprën e kryer, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimin siç parashihet ne dispozitat e nenit 41 të KPRK-së, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP-së, i dëmtuar [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Kaçanik për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPRK-së, obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë /€ në afat prej 30 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.


Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.342/15 me datë 22.02.2018

**Zyrtare Ligjore,
Ganimete Avdiu**

**Gjyqtarja,
Hakile ILAZI**



Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit Kosovës, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh. Kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.